



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT EUGLENT OSMANAJ



Tiranë, më 15.09.2022

Nr. 686/2 Dosje

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT-TIRANE.

Per dijeni:

-**Debitorit:** Shoqeria "DURRES CONTAINER TERMINAL" sha, me Nipt , L12126504E
Adresa: Lagjja 4, Rruga Egnatia, Zona Kadastrale 8514, Nr.Pasurie 4/210-N1, Durres.

-**Kreditorit:** Autoriteti i Konkurences

Unë, Euglent OSMANAJ , me detyrën e Përmbarduesit Gjyqësor Privat , në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 1005 Regj të lëshuar më datë 10.12.2020 prej Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë, Tirane kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbardimore Nr. 686, Datë 17.08.2022 kërkesën e kreditorit "Autoriteti i Konkurences" ndaj debitorit Shoqeria "DURRES CONTAINER TERMINAL" sha , në lidhje me titullin ekzekutiv ,Vendimin Nr. 696, date 11.06.2020 të Autoritetit të Konkurences të Transferuar me kërkesë të kreditorit nga Zyra e Përmbardimit Privat "EPSA".

Pasi është filluar procesi i ekzekutimit të detyrueshëm, debitorit i është dërguar Lajmërimi Nr.05 Dosje, Datë 23.02.2021 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr.1005 Regj, date 23.02.2021 në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

Adresa:Blv:Gjergj Fishta, Nd.3, Hyrja 6, Ap.8 , Njesia 10 , Tirane.
Email:euglentosmanaj@yahoo.com
Cel:069 74 90 508

KONSTATOVA Se :

Debitori Shoqeria **Shoqeria "DURRES CONTAINER TERMINAL" sha** sh.p.k ka marre dijani per detyrimin dhe nuk e ka permbushur ate brenda afatit te lajmerimit per ekzekutim vullnetar

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit **Shoqeria "DURRES CONTAINER TERMINAL" sha, me Nipt , L12126504E** , në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Në këto kushte, referuar nenit 519, 527 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe të Ligjit Nr. 26, datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ

- Venien e mases se sekuestros konservative mbi aktivet e debitorit Shoqeria "DURRES CONTAINER TERMINAL" sha, me Nipt , L12126504E , deri ne nje urdher te dyte te permbaruesit gjyqesor.**
- Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
- Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm në emër të debitorëve të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të tujve ekzekutive.
- Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtë ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijani.

PËRMBARUES GJYQËSOR

Euglent OSMANAJ

Adresa:Blv:Gjergj Fishta, Nd.3, Hyrja 6, Ap.8 , Njesia 10 , Tirane.

Email:euglentosmanaj@yahoo.com

Cel:069 74 90 508